



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAVAJË

KËSHILLI BASHKIAK

Kavajë, më 25.9. 2020

V E N D I M

Nr. 99, datë 25/9/2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË PARAQITJES DHE SHQYRTIMI I ANKESAVE, VËREJTJEVE, KËRKESAVE, I PETICIONEVE DHE INISIATIVAVE QYTETARE TË KËSHILLIT BASHKIAK KAVAJË

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, dhe 2 pjesa gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, neni 18, neni 54 gërma “a” neni 55 pika 3 dhe pika 6 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së paraqitjes dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, i Peticioneve dhe Inisiativave Qytetare sipas materialit bashkalidhur.

2. Ngarkohet Këshilli Bashkiak për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

SEKRETAR I KESHILLIT BASHKIAK KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Bardhi Byku



Ilir Hoxha



RREGULLORE
SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I PETICIONEVE
DHE INICIATIVAVE QYTETARE

KËSHILLI BASHKIAK KAVAJË

Miratuar me Vendim Nr. __, dt. __.08.2020

Tabela e përmbajtjes

KREU I.....	1
DISPOZITA TE PERGJITHSHME.....	1
Baza ligjore.....	1
Qëllimi i rregullores.....	1
Përkufizime.....	1
KREU II. PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I PETICIONEVE	2
E Drejta e Paraqitjes së Peticionit.....	2
Çështje për të cilat mund ti drejtohesh Këshilli me petition	2
Parashtruesit e Peticionit.....	3
Nënshkrimi i Peticionit.....	3
Refuzimi i pranimit të petitionit për shqyrtim nga Këshilli	4
Forma dhe Përmbajtja e Peticionit.....	4
Regjistrimi dhe Dorëzimi i Peticionit.....	5
Komunikimi me parashtruesin person kontakti për petitionin.....	6
Vlerësimi i Peticionit.....	6
Njoftimi i Pranimit të Peticionit	6
Tërheqja e Peticionit.....	7
Shqyrtimi i petitionit.....	7
Peticione të zakonshme.....	8
Peticione që kërkojnë debat në një Komision të Përhershëm të Këshillit	9
Peticione që kërkojnë debat në një Mbledhje Këshilli	9
Peticionet Elektronike.....	10
Nënshkrimi i peticonit eletronik	10
Shqyrtimi i Peticioni me Debat ne Mbledhjen e Këshillit	11
Afatet e Shqyrtimit të Peticionit	11
Mbjajtja e takimit publik për petitionin.....	11
Veprimet e Këshillit me Peticionet.....	11
Kërkesa e Peticionit për Mbajtjen e Takime Publike	13
Peticion në lidhje me një çështje që është në proces këshillimi publik nga këshilli.....	13
Privacia dhe Konfidencialiteti	13
Raporti për Peticionet	13
Ankesa ndaj përgjigjes së Këshillit për petiionin.....	14
Administrimi i regjistrit të peticioneve.....	14
KREU III. PETICIONET PËR INICIATIVË QYTETARE.....	14
E drejta e iniciativës qytetare.....	14
Objekti i Iniciativës qytetare.....	14
Nënshkruesit e petitionit për iniciativë	14
Parashtruesit e Peticionit për Iniciativë	15

Mënyra dhe forma e paraqitjes së Iniciativës Qytetare.....	15
Dorëzimi i Peticionit për Iniciativë Qytetare dhe Pranimi.....	16
Verifikimi i Peticionit.....	16
Qarkullimi për Nënshkrim i Peticionit për Iniciativë Qytetare nga Mbështetësit.....	16
Konsultimi me Kryetarin e Bashkisë për Iniciativën Qytetare.....	16
Mbledhja e nënshkrimit për Peticionin për Iniciativë Qytetare.....	17
Verifikimi i nënshkrimeve për Peticionin për Iniciativë Qytetare.....	17
Paraqitja e peticionit për shqyrtim në Mbledhjen e Këshillit.....	17
Seanca dëgjimore për Iniciativë Qytetare.....	18
Tërheqja e Peticionit për Iniciativë Qytetare.....	18
Tërheqja e Peticionit për Iniciativë Qytetare.....	18
Privacia dhe Konfidencialiteti.....	18
Shtojcat.....	19
Shtojca nr. 1 Model peticion dërguar Këshillit Bashkiak.....	20
Shtojca nr. 2 Model peticion për iniciativë qytetare dërguar Këshillit Bashkiak.....	21
Shtojca nr. 3 Model regjistri i peticioneve.....	21
Shtojca nr. 4 Model regjistri i nismave qytetare.....	21

15
16
16

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Baza ligjore është Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 19:

1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t’u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje Këshillit Bashkiak për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e Bashkisë.
2. Këshillit Bashkiak është i detyruara t’ë marrë në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore synon të mundësojë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit në demokracinë e drejtpërdrejtë duke mundësuar propozimin, nëpërmjet peticionit, si dhe të miratimin apo ndryshimin e një akti normativ nënligjor, apo të hedhin poshtë një vendim apo rregullore të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Neni 1

Përkufizime

Grup interesi: është organizatë apo një grup organizatash jofitimprurëse që përfaqësojnë interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Këshilltarësh të pavarur.

Grup nismëtar: është një grup qytetarësh, me të drejtë vote, që marrin iniciativën, hartojnë dhe paraqesin tek Këshilli kërkesën për iniciativë qytetare apo referendum vendor sipas kërkesave dhe procedurave ligjore.

Iniciativë qytetare: është një metodë e demokracisë së drejtpërdrejtë që lejon qytetarët dhe grupet e interesit të propozojnë, nëpërmjet nje peticioni, miratimin apo ndryshimin e një akti normativ nënligjor, apo të hedhin poshtë një vendim apo rregullore të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Propozim me shkrim dhe i nënshkruar nga propozuesit, i paraqitur nga çdo grup komuniteti për vendimmarrje, nëpërmjet përfaqësuesve të tij të autorizuar sipas Ligjit, ose jo më pak se një për qind (1%) e banorëve të bashkisë, dhe që ka për qëllim marrjen e vendimeve për çështje që janë brenda juridiksionit të Bashkisë dhe janë në kompetencën ligjore të Këshillit.

Mbledhës nënshkrimesh: është një individ që u kërkon votuesve të nënshkruajnë një peticion, dhe që ndjek dhe është dëshmitar i nënshkimit të peticiotit.

Peticion: është një kërkesë, ankese apo verejtje¹ për veprim e bërë me shkrim nga një grup qytetarësh ose banorësh, apo grup organizatash apo grupe interesi, dhe që i adresohen Këshillit Bashkiak për çështje në kompetencë ligjore të Këshillit Bashkiak, e cila ka për qëllim të nxisë Këshilli të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me çështjen objekt të peticionit. Peticioni është i hapur për çdo qytetar ose banor, ose grup qytetarësh ose banorësh.

E-Peticion: electronic petition means a petition where the petition is created and circulated electronically and the signatories have added their details by electronic means;

Qarkullues peticioni: është një individ që u kërkon votuesve të nënshkruajnë një peticion dhe e nënshkruan peticionin në tagrin e qarkulluesit. I cili/a mund të jetë vullnetar apo profesionist me pagesë.

Vërejtje: Komunikim në formë shkresore apo elektronike, që ka për qëllim të sjellë në vemendjen e Këshillit një problem, pa pritur një përgjigje zyrtare nga Këshilli.

KREU II.PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I PETICIONEVE

Neni 3

E Drejta e Paraqitjes së Peticionit

1. Peticioni është një kërkesë për Këshillin Bashkiak, për t'u marrë me çështjet specifike apo për të miratuar akte të caktuara, për të siguruar mbështetje apo për të kundërshtuar një çështje që po debatohet nga Këshilli apo Komisioni, apo për të shprehur një shqetësim apo prioritet.
2. Çdo person apo organizatë që ka një interes në punët e Bashkisë dhe kushdo që jeton, punon apo studion në territorin e Bashkisë ka të drejtë të parashtojë dhe të nënshkruaj një peticion drejtuar Këshillin Bashkiak/ Komisionit të Përhershëm,

Neni 4

Çështje për të cilat mund ti drejtohesh Këshilli me peticion

1. Qytetarët dhe organizatat mund t'i drejtohen Këshillit me peticion për:
 - a. çështje që lidhen me përgjegjësitë ligjore të Këshillit
 - b. çështje që prekin Bashkinë ose komunitetet e Bashkisë, dhe për të cilat Këshilli është në gjendje të ushtrojë njëfarë ndikimi për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

¹Sipas nenit 19 te ligjit 139/2015

2. Nëse kërkesa e peticionit ka të bëjë me diçka mbi të cilën Këshilli nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë, Këshilli do të konsiderojmë përfaqësimin në emër të komunitetit për autoritetin publik përkatës.
3. Kur një peticion ka të bëjë me një çështje mbi të cilën Këshilli nuk ka as përgjegjësi dhe as ndikim, Këshilli do t'ia kthejë peticionin tek organizatori person i kontaktit i peticionit me një shpjegim për vendimin e kthimit, dhe nëse do të jetë e mundur do t'u japë organizatori person i kontaktit çdo informacion që Këshilli ka në dispozicion se ku kërkesa e peticionit duhet të ridrejtohet.

Neni 5

Parashtruesit e Peticionit

1. Çdo person që jeton, punon apo studion në territorin e Bashkisë ka të drejtë të jetë organizator i një peticioni drejtuar Këshillin Bashkiak/ Komisionit të Përherëshëm.
2. Parashtruesit e peticionit mund të jetë kryetari i fshatit, ndërmjetësi komunitar, drejtuesi i zonës së përmirësimit të biznesit, apo struktura të tjera me bazë komunitare që ngrihen mbi bazë të ligjit.
3. Nëse parashtruesit përfaqësojnë një organizatë, ato duhet të marrin dhe paraqesin tek Bashkia autorizimin nga organizata për të qënëparashtrues të peticionit.
4. Parashtruesit e peticionit nuk mund të jenë deputet ose anëtarë të Këshillit Bashkiak _____.
5. Nëse peticioni nuk përcakton qartë se kush është parashtruesi/t, Këshilli nuk do tashqyrtojë peticionin.

Neni 6

Nënshkrimi i Peticionit

1. Peticioni nënshkruhet nga parashtruesi/t dhe mbështetësit.
2. Nënshkrimi bëhet me bojë.
3. Asnjë person nuk lejohet: a) të nënshkruaj në emrin e një personi tjetër në çfarëdo rrethane, b) të nënshkruaj një peticion më shumë se një herë, c) të nënshkruaj një peticion kur nuk ka të drejtë ta nënshkruani atë.
4. Një person nuk mund të nënshkruaj njëkohësisht një peticion në letër dhe një peticion elektronik, të dy për të njëjtën çështje.
5. Këshilli ka të drejtën të verifikojë emrin dhe adresën dhe nënshkrimin e çdo personi që mbështet peticionin nëse e konsiderojmë të nevojshme.
6. Parashtruesi/t i peticionit duhet të vendosë nëse kur ka mbledhur nënshkrime të mjaftueshme për t'i dërguar Këshillit kërkesën e peticionit.
7. Nënshkrimet e peticionit do të konsiderohen të vlefshme përsa kohë nuk është vertetuar pavlefshmëria e tyre.

8. Nënshkrimet e pasuara nga një datë e nënshkrimit e cila është më shumë se gjashtë muaj para datës së paraqitjes së petitionit, do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 7

Refuzimi i pranimit të petitionit për shqyrtim nga Këshilli

Këshilli mund të refuzojë pranimit të petitionit për shqyrtim në rastet kur:

1. Çdo çështje për të cilën Këshilli nuk kapërgjegjësi të drejtpërdrejtë ose nuk ka ndikim.
2. Çdo çështje që lidhet me një vendime për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
3. Çdo çështje që lidhet me një kërkesë për licence/ leje/ përfitim financiar apo tjetër
4. Një petition per çështje që janë të përcaktuara në ligj.
5. Çdo çështje për të cilën egziston një proces ligjor apelimi administrativ apo një procedurë ligjore e veçantë e ankimit.
6. Çdo çështje specifike për të cilën Këshilli po kryen një këshillim publik nga Këshillit.
7. Një petition me një kërkesë të njëjtë që Këshilli ma marrë nga një petition tjetër për të njëjtën çështje brenda dy viteve të fundit. Në këtë rast Këshilli do enjoftojë me shkrim parshtruesin të petitionit dhe do të përfshijmë një kopje të përgjigjes ndaj petitionit të parë të marrë.
8. Çdo petition për të cilin ne konsiderojmë se është shqetësues, abuziv ose ndryshe papërshtatshëm, shpifës, false ose me deklarata shpifëse.
9. Çdo kërkesë që i kërkon Këshillit të bëjë një gjë të paligjshme.
10. Çdo petition në lidhje me objektin e ndonjë veprimi juridik të ndërmarrë nga Këshilli apo një individ.
11. Çdo petition i cili përmban informacion konfidencial për shembull në lidhje me një individ specifik
12. Kërkesa e petitionit nuk është e qartë.
13. Peticioni përmban informacione jo të plota ose të pavlefshme, siç është për shembull nuk adresat e paplota dhe të pasakta të organizatorëve dhe mbështetësve të petitionit.
14. Këshilli nuk është në gjendje të identifikojmë nëse njerëzit që kane firmosin petitionin jetojnë, punojnë apo studiojnë në Bashkia.
15. Peticioni nuk ka nënshkrime të të mjaftueshme dhe të vlefshme për të përmbushur pragun për një petition të zakonshëm që i dërgohet Këshillit.
16. Peticioni që i dorëzohen Këshillit dy muaj para zgjedhjeve vendore në Bashki.

Neni 8

Forma dhe Përmbajtja e Peticionit

1. Peticionet i drejtohen Këshillit në fomë të shkruar dhe nënshkruhen në shkresë apo në formë elektronike.

2. Peticionet që pranohen për shqyrtim me shkresë, kanë të dhënate mëposhtme në secilën fletë të peticionit:
 - a. citimin që i drejtohet Këshilli Bashkiak _____,
 - b. emrin dhe mbiemrin, adresën e banimit/ punës/ studimit, adresën elektronike dhe numra e telefonisë fikse dhe celulare, si dhe nënshkrimin e parashtruesit/ve.
 - c. kërkesa e peticionit, që shpreh qartë atëse çfarë veprimi i kërkohet të ndërmerret Këshilli / Komisioni i Përhershëm, e cila citohen në secilën faqe të nënshkruar të peticionit dhe fillon me shprehjen "Ne të nënshkruarit me këtë peticion i kërkojmë Këshillin Bashkiak _____"
 - d. arsyet e paraqitjes së peticionit
 - e. bazën ligjore të peticionit
 - f. nënshkrimet e mbështetësve të peticionit, të cilat duhe të bëhen me bojë.
 - g. Deklaratën se "Të gjitha informacionet dhe nënshkrimet e peticionet janë janë të vërteta dhe të sakta".
 - h. Numrin e faqes (p.sh. faqja 1 nga 8, faqja 2 nga 8 etj).
 - i. Çdo rrjesht me emrin, kontakte dhe nënshkrimin e nënshkruesve duhet të ketë një numër.
 - j. Peticioni duhet të jetë i shkruar apo të shtypet në njërën anë të fletës A4, në letër të bardhë.
3. Peticioni duhet të jetë i shkruar apo shtypur qartë.
4. Peticionet mund të shoqërohet me dokumente shtesë.
5. Peticioni për tu shqyrtuar nga Këshilli/ Komisioni i Përhershëm duhet të ketë sëpaku 50 nënshkrues, përfshirë organizatorët dhe mbështetësit, që janë persona që banojnë, punojnë apo studiojnë në territorin e Bashkisë. Një peticion me më pak se 50 emra do të pranohet për shqyrtim nëse nënshkruesit përbëjnë shumicën e banorëve dhe / ose grupit të interesuar të prekura nga çështja e ngritur.

Neni 9

Regjistrimi dhe Dorëzimi i Peticionit

1. Peticionet mund t'i dërgohen Këshillit në formë të shkruar, me shkresë apo në formë elektronike.
2. Peticioni me shkresë dorëzohet dhe regjistrohet në zyrën e protokollit të Bashkisë.
3. Për zhvillimin e peticioni elektronik do të përdoret platforma elektronike e Këshillit e shfaqur në faqes zyrtare të interneti të Bashkisë.
4. Nëse parashtruesit e peticionit duan të paraqesin një peticion në një mbledhje të Këshillit, ose në një mbledhje të Komisionit të Përhershëm, peticioni duhet të regjistrohet në zyrën eprotokollit të Bashkisë, apo të dorëzohet në postë jo më vonë se 15 ditë pune para datës së mbledhjes.
5. Peticioni mund t'i dorëzohet edhe një Këshilltari, i cili/a më pas e paraqitet nëpërmjet mocionit në një Mbledhje të Këshillit. Këshilltari duhet ta dorëzojë peticionin tek Sekretari sëpaku 15 ditë pune para mbledhjes se Këshillit ku do paraqitet peticioni.

Neni 10

Komunikimi me parashtruesin person kontakti për peticionin

1. Komunikimi i Këshillit bëhet me parashtruesin person kontakti për peticionin.
2. Nëse peticioni nuk identifikon një kontakt kryesor të peticionit, Këshilli do të supozojë se parashtruesi nënshkruesi i parë është person kontakti i peticionit.

Neni 11

Vlerësimi i Peticionit

1. Këshilli ka të drejtën të verifikojë emrin dhe adresën dhe nënshkrimin e çdo personi që mbështet peticionin nëse e konsiderojmë të nevojshme për ndonjë arsye.
2. Peticioni, termat e të cilit konsiderohen si të pakuptueshëm, të papërshtatshëm fyes ose të palexueshëm, klasifikohet nga Këshilli komunal. Vendimi u komunikohet hartuesve të tij.
3. Nëse peticioni, për nga objekti i tij, qartazi nuk bën pjesë në kompetencat e Këshillit komunal, ky i fundit ia transmeton autoritetit përkatës Bashkisë, Këshillit të Madh, Këshillit të shtetit, autoriteteve të bashkive të tjera) pasi ka ruajtur një kopje.
4. Nëse peticioni nuk përcakton qartë se kush janë organizatorët, Këshilli nuk do të shqyrtojë peticionin.
5. Sekretari i Këshillit i dërgon kryesuesit të peticionit një shkresë ku i konfirmon marrjen e peticionit, brenda 5 ditëve nga regjistrimi i peticionit në protokollin e Bashkisë.
6. Një peticion elektronik nuk mund të zhvillohen njëkohësisht me në peticionin me shkresë, ndërkohë që ata kanë të njëjtën kërkesë dhe të njëjtët organizatorë. Në këtë rast Këshilli refuzon peticionin elektronik dhe merr parasysh peticionin me shkresë. Këshilli refuzon peticionin elektronik edhe në rastin kur peticioni elektronik paraqitet me të njëjtën kërkesë dhe të njëjtët organizatorë me peticionin me shkresë, deri në 6 muaj nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të Këshillit për peticionin me shkresë.

Neni 12

Njoftimi i Pranimit të Peticionit

1. Brenda 10 ditëve të punës nga rregjistrimi i peticionit në Bashki, Sekretari i dërgon njoftim organizatorit person kontakti për pranimin e peticionit. Në njoftim shpjegohet çfarë ka bërë apo planifikon të bëjë Këshilli me peticionin.
2. Në njoftim Sekretari sqaron:
 - a. nëse kërkesa e peticionit përfshihet në rregullat proceduriale të Këshillit për shqyrtimin e peticioneve;
 - b. organin e Këshillit apo të ekzekutivt të Bashkisë që do i dërgohet peticioni për shqyrtim dhe propozim.
3. Kur vlerësohet se kërkesa e peticionit nuk përfshihet në rregullat proceduriale të Këshillit për peticionet, Këshilli do të këshillojë organizatorin e peticionit për arsyen e këtij vendimi.

4. Peticioni i pranuar bëhet publik nga Sekretari në faqene internetit të Bashkisë, tek ndërfaqja e peticioneve.

Neni 13

Tërheqja e Peticionit

1. Prashtruesi i peticionit mund ta tërheqë peticionin në çdo kohë përpara se Sekretari të vërtetojë se peticioni është kualifikuar për prezantim në Këshill.
2. Një nënshkrues i peticionit mund të tërheqë nënshkrimin e tij / saj duke paraqitur Sekretarit një revokim të verifikuar të nënshkrimit nga peticioni përpara pranimit të peticionit nga Sekretarit.

Neni 14

Shqyrtimi i peticionit

1. Kryetari e njëj Këshillin me të gjitha peticionet e pranuar gjatë seancës që pason marrjen e tyre dhe me propozimin e tij,
2. Peticionet, të cilat i drejtohen Këshillit shqyrtohen fillimisht nga Komisionet e Përhershme përkatëse. Kryetari i Këshillit i dërgon peticionin Komisionit të Përhershëm përkatës dhe Komisionit të Përhershëm për Mandatet, Rregullore, Çështjeve Juridike, Zgjedhjet dhe Peticioneve i cili jem mendim për aspekte ligjore të peticionit.
3. Kryetari i Komisionit të Përhershëm mund t'i kërkojë organizatorit kryesor të peticionit sqarime shtesë në lidhje me përmbajtjen e peticionit.
4. Komisioni i ngarkuar me shqyrtimin e peticionit dëgjon si rregull i përgjithshëm, parashtruesin e peticionit ose përfaqësuesit e tyre, si edhe përfaqësuesin e Bashkisë. Pas studimit dhe diskutimit, Komisioni i propozon Këshillit:
 - a- pranimin e kërkesës së peticionit
 - b- dërgimin e motivuar të peticionit tek Bashkia për studim dhe raport-opinion;
 - c- mos pranimin e kërkesës së peticionit
 - d- dërgimin e peticionit tek autoriteti kompetent;
5. Teksti i peticionit i shoqëruar me raportin e Komisionit i dërgohet këshilltarëve si edhe një përfaqësuesi të hartuesve të peticionit
6. Peticioni dhe nënshkrimet janë të hapura për publikun, dhe kjo citohet në dokumentin e peticionit.
7. Jo më shumë se 3 peticione mund të shqyrtohen në një mbledhje të Këshillit apo Komisionit të Përhershëm.
8. Këshilli nuk e debaton peticionin përpara se peticioni shqyrtohet nga Komisioni i Përhershëm që mbulon çështjen që trajton peticioni. Kur peticioni ka më shumë se 1500 nënshkrime të vlefshme, Këshilli e debaton sipas procedurave të Tij, por jo më shumë se 15 minuta. Mbas debatit Këshilli vendos për të ndërmarrë veprimin që kërkon peticioni, te mos marrë veprimin që kërkon peticioni duke sqaruar arsyet, apo tja përcjellë Komisionit të Përhershëm përkatës për vlerësim dhe hetim të metejshëm.

9. Pas shqyrtimit në Këshillin e Bashkisë, dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit, Sekretari njofton me shkrim parashtruesit/n e petitionit për vendimin e Këshillit dhe për hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e çështjes së ngritur në petition. Ky vendim do të publikohet në faqen e internetit të Këshillit.
10. Jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së petitionit nga Komisionit të Përhershëm, kryetari i Komisionit e paraqet petitionin në Komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e zgjidhjes ligjore ose mospranimin e petitionit. Në rast se Komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë Kryetarin e Komisionit për të paraqitur një deklaratë në Mbledhjen e Këshillit.
11. Nëse një petition me shkrim dhe një petition elektronik zhvillohen në të njëjtën periudhë dhe për të njëjtën çështje, të dy petitionet do të shqyrtohen nga Këshilli pasi të jenë depozituar më parë të dy pranë Këshillit.
12. Në raste kur peticioni, lidhen me çështje për të cilat Bashkia dhe Këshilli Bashkiak nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Këshillit brenda afatit prej 10 ditësh e njofton me shkrim parashtruesin e petitionit se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e petitionit, si dhe e përcjell atë tek organet kompetente, duke njoftuar njëkohësisht edhe parashtruesin e petitionit.
13. Peticionet e paraqitura nga parashtruesi i petitionit apo Këshilltari, në mbledhjet e Këshillit nuk do të diskutohen në detaje në atë mbledhje, përveç nëse ekziston një pikë e rendit të punëve të Këshillit që trajton një temë që lidhet posaçërisht me atë çështje. Peticionet e paraqitura në këtë mënyrë do t'i kalojnë Komisionit të Përhershëm përkatës apo ekzekutivit të Bashkisë.
14. Kur peticioni paraqitet nga një Këshilltar, në emër të parashtruesit të petitionit dhe ku ai/ajo është e pranishme, procedura që duhet të ndiqet gjatë debatit për petitionin është e njëjtë si për çdo mocion tjetër dhe përcaktohet në Rregulloren e Mbledhjes së Këshillit.
15. Peticionet nuk do të shqyrtohen në një Mbledhje të Jashtëzakonshme të Këshillit, përveçse nëse tema e mbledhjes për të cilën është thirrur Mbledhja e Jashtëzakonshme ka të bëjë me çështjen që paraqet peticioni.

Neni 15

Peticione të zakonshme

1. Peticionet e zakonshme duhet të nënshkruhen nga të paktën 20/50 persona që jetojnë, punojnë ose studiojnë në Bashki. Peticionet me më pak se 20/ 50 nënshkrime të vlefshme bien jashtë procedurës së trajtimit të kësaj rregullore në këtë kre, por në çdo rast ato do t'i përcillen drejtorisë përkatëse, nga Sekretari i Këshillit.
2. Peticionet e zakonshme i përcillen drejtorisë përkatëse të Bashkisë, nëpërmjet Sekretarit. Drejtoria duhet t'i përgjigjen organizatorit të petitionit brenda gjashtë (6) javëve nga data e letrës së pranimit të petitionit të dërguar organizatorit të petitionit, ku shpjegohet se çfarë veprimi kanë ndërmarrë Këshilli për kërkesën e petition.
3. Nëse kërkohet më shumë kohë, drejtoria përkatëse i shkruan organizatorit të petitionit ku i citon edhe datën kur do të dërgohet përgjigjia.

- ditë nga
min e
Ky
4. Një kopje e përgjigjes dërguar organizatorit të petitionit, drejtoria përkatëse ia dërgon Kryetarit të Këshillit.

Neni 16

Peticione që kërkojnë debat në një Komision të Përhershëm të Këshillit

1. Peticionet që kanë mbi 200 nënshkrime të vlefshme do të kenë të drejtë të shqyrtohen nga një Komision të Përhershëm i Këshillit, i cili ka objekt të veprimtarisë së tij çështjen që paraqet peticioni.
2. Nëse çështja e cilë bën fjalë peticioni është në rendin e ditës së Komisionit, organizatori kryesor i petitionit ftohet për të paraqitur peticionin në mbledhjen e Komisionit, apo ai/ajo mund të përzgjedhë një nga Këshilltarët Bashkiakë për ta paraqitur kërkesën e petitionit.
3. Organizatori ka 5 minuta kohë për të prezantuar peticionin, ndërkohë anëtarët e Komisionit kanë 30 minuta kohë për të debatur mbi peticionin, përpara se Këshillit të marrë një vendim se si do ti përgjigjet kërkesës së petitionit. Do devijim nga kjo procedurë do të jetë në diskrecionin e Komisionit.
4. Nëse peticioni nuk do të shqyrtohet në mbledhjen e Komisionit, peticioni do të futen në rendin e punëve të mbledhjes se radhës së Komisionit, por jo më vonë së tre mbledhje të radhës nga data e regjistrimit të petitionit në Bashki.
5. Prashtruesit të petitionit do t'i jepet një kopje e procesverbalit që përmban rekomandime dhe çdo përgjigje vijuese.

Neni 17

Peticione që kërkojnë debat në një Mbledhje Këshilli

1. Peticionet që kanë mbi 1000 nënshkrime të vlefshme do të kenë të drejtë të shqyrtohen nga një Mbledhje të Këshillit.
2. Organizatori kryesor i petitionit ftohet për të paraqitur peticionin në mbledhjen e Këshillit, apo ai/ajo mund të përzgjedhë një nga Këshilltarët Bashkiakë për ta paraqitur kërkesën e petitionit.
3. Organizatori ka 5 minuta kohë për të prezantuar peticionin, ndërkohë Këshilltarët kanë 30 minuta kohë për të debatur mbi peticionin, përpara se Këshillit të marrë një vendim se si do ti përgjigjet kërkesës së petitionit.
4. Asnjë debat për peticionin nuk do të zhvillohet në mbledhjen e Këshillit ku shqyrtohet buxheti i Bashkisë.
5. Prashtruesit të petitionit do t'i jepet një kopje e procesverbalit që përmban rekomandime dhe çdo përgjigje vijuese.
6. Nëse organizuesi i petitionit nuk është kënaqur me vendimin e Këshillit, mund të paraqesë një ankesë në Këshill përmes sitemit të trajtimit të ankesave

Neni 18

Peticionet Elektronike

1. Peticionet elektronike zhvillohen dhe dorëzohen përmes faqes së internetit, dhe duhet të respektojnë të njëjtat kërkesa dhe procedura si peticionet me leter.
2. Parashtruesi/t e peticionit dorëzojnë me shkrim në zyrën e protokollit të Bashkisë kërkesën për krijimin e peticionit elektronik, sëbashku me të dhënat e peticionit.
3. Parashtruesi/t e peticionit duhet t'i sigurojë Këshillit emrin, adresën postare, adresën e postës elektronike dhe numrat e telefonisë fikse dhe/ apo celularit.
4. Parashtruesi/t e peticionit duhet të pëcaktoshin për sa kohë dëshiron që peticioni të mbetet e Hapur për nënshkrime.
5. Përmbajtja e peticionit kontrollohet nga Sekretari dhe brenda pesë (5) ditëve pune Bashkia mundëson publikimin online të peticionit.
6. Nëse Sekretari vendos se nuk mund të publikohet peticioni, i dërgon njoftim me shkrim parashtruesit person kontakti, brenda 5 ditëve pune nga regjistrimi i kërkesës për peticionin, arsyet e refuzimit dhe i kërkon ta rishohë përmbajtjen dhe formën e pyetësorit.
7. Nëse parashtruesi nuk të mundësojë përmirësimin apo rregullimin e peticionit, Sekretari brenda 10 ditëve të punës, publikon në faqen e internet të Bashkisë, nderfaqja e peticioneve, një një përmbledhje e peticionit dhe arsyeja pse nuk është pranuar do të publikohet nën seksionin pet peticione të refuzuara 'të faqes së internetit
8. Kur një peticion elektronik mbyllet për nënshkrime, ai automatikisht do i dërgohet Sekretarit për të ndjekur procedurat si peticionet me letër.
9. Sekretari do i dërgojë një njoftim parashtruesit të peticionit dhe mbështetësve, 15 ditëpune nga mbyllja e peticionit. Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të internet të Bashkisë.

Neni 19

Nënshkrimi i peticonit eletronik

1. Për të nënshkruar peticionin elektronikmbështesit duhet të fusin në aplikacion e peticionit të dhënat si emrin, adreseë postare apo kodin postar dhe një adresë të vlefshme emaili.
2. Nënshkruesi do të marrë një email në adresën e emailit ku mund të klikohet një lidhje me anë të së cilës do të konfirmohet nëse adresa e emailit është e vlefshme.
3. Sapo të bëhet i plotë ky hap mbështetësi do të jetë shtuar si nënshkrues i peticionit.
4. Njerëzit që vizitojnë peticionin elektronik do të jenë në gjendje të shohin emrin e mbështetësit dhe njësinë administrative ku banon, por jo detajet e kontaktit të tij/saj.

Neni 20

Shqyrtimi i Peticioni me Debat ne Mbledhjen e Këshillit

1. Kur një peticion që kërkon debat Këshill është paraqitur në përputhje me procedurët e trajtimit të peticioneve, dhe është debati për peticionin është përfshirë në një mbledhje të zakonshme ose të jashtëzakonshme të Këshillit, parashtruesi person kontakti i peticionit ose një person të emëruar për të vepruar në emër të tij, do të lejohet të flasë për maksimum 5 minuta në mënyrë që të paraqesë peticionin e tyre në Këshill.
2. Një anëtar i Këshillitqë do të marrë pjesë në debat për peticionin, mund të flasë vetëm një herë dhe për maksimum 5 minuta për çështjen e ngritur nga Peticioni. Debatit për peticionin zgjat maksimumi 30 minuta, përveç se kur shumicaa e Këshilltarëve në Mbledhje vendosin për shtyrjen e afatit.
3. Në fund të Debatit vendimi i Këshilli mund të përfshijë:
 - a. Ndërmarrja e veprimit të kërkuar në Peticion, me ose pa modifikime;
 - b. Duke e mbajtur shënim peticionin, por duke mos ndërmarrë veprimet e kërkuara në peticion;
 - c. Kërkesën për hetimeve të mëtejshme për çështjen, nga nje komisioni i përhershëm i këshillit apo nga ekzekutivi i bashkisë
 - d. Vendosja nëse do të bëni rekomandime për Ekzekutivin ku çështja i takon Ekzekutivit për të marrë vendimin përfundimtar.
4. Këshilli do të njoftojë më shkrim parashtruesin person kontakti për vendimin e marrë nga Këshilli pas debatit për peticionin dhe kjo do të publikohet në faqen e interbnetit të Bashkisë.

Neni 21

Afatet e Shqyrtimit të Peticionit

Peticionet shqyrtohen nga Këshilli i Bashkisë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.

Neni 22

Mbajtja e takimit publik për peticionin

Kryetari i Këshillit/ Komisionit të Përkërkshëm mund të kërkojnë mbajtjen e një takimit publik në të cilin komuniteti diskuton, bashkë me Këshilltarët, apo kryetarin e fshatit / ndërlihdhësin komunitar dhe punonjësit e Bashkisë, për çështjen që citon peticioni.

Neni 23

Veprimet e Këshillit me Peticionet

Këshilli mbas shqyrtimit të peticionit, ndërmerr veprimet si më poshtë:

1. Merr vendimin apo ndërmerr veprimin e kërkuar në peticion
2. I shkruan parashtruesittë peticionit duke parashtruar pikëpamjet e Këshillit në lidhje me kërkesën në peticion.
3. Dërgon peticionin për shqyrtimin në një komision të përhershëm të Këshillit.

4. Mban një takimi me parashtruesit e petitionit për të kuptuar arsyet e dergimit të petitionit dhe mënyrën më të mirë për zgjidhur çështjen që paraqet peticioni.
5. Mban takim/e publike për të diskutuar çështjen e petitionit.
6. Vendos për ndërmarrjen e një hulumtimi të çështjes.

1. Një
Kë

2

Neni 24

Kërkesa e Peticionit për Mbajtjen e Takime Publike

1. Një peticion mund të kërkojë mbajtjen nga Këshilli të një mbledhje publike në lidhje me kërkesën bazë të peticionit.
2. Kërkesa e peticionit për mbajtjen e takimit/ve publike nuk mund të bëhet për ato raste kur Këshilli ka detyrimin ligjor (Ligji nr. 139/2015) për mbajtjen e takimeve publike.

Neni 25

Peticion në lidhje me një çështje që është në proces këshillimi publik nga këshilli.

1. Në rastet kur Këshilli merr një peticion në lidhje me një çështje që është në proces këshillimi publik nga Këshilli, shqyrtimi i peticionit do të pezullohet.
2. Nëse peticioni përfshihen automatikisht në procesin zyrtar të këshillimit publik, organizatorët e peticionit do të informohen nga Sekretari për këtë vendim të Këshillit.
3. Përveç përfshirjes në procesin zyrtar të këshillimit publik, të gjitha peticionet që kanë lidhje me çështjen e buxhetit të Bashkisë do të vihen në dispozicion në mbledhjen e Këshillit për shqyrtin e buxhetit.
4. Në rastin kur peticioni dorëzohet pasi ka kaluar afati i këshillimit publik, por para se të merret vendimi përfundimtar nga Këshilli, dhe nëse çështje specifike po diskutohet në njërin nga Komisionet e Përhershëm, organizatori person kontakti do të ftohet në mbledhjen e komisionit për të bërë prezantimin e kërkesës së peticionit.
5. Nëse çështja tashmë është shqyrtuar nga Komisionet e Përhershëm, peticioni do të merret në shqyrtimi në momentin kur Këshilli do të marrë vendim për çështjen.

Neni 26

Privacia dhe Konfidencialiteti

1. Parashtruesit e peticionit duhet të njihet me përgjegjësitë e tyre në lidhje me mbledhjen e informacionit personal (emrat, adresën dhe nënshkrimet) e mbështetësve.
2. Parashtruesit e peticionit nuk duhet të shpërndajnë informacioni tek palë të treta, përveç se tek Këshilli Bashkiak _____

Neni 27

Raporti për Peticionet

1. Sekretari harton listën dhe raportin vjetor të peticioneve.
2. Raporti paraqet peticionet për të cilat është dhënë përgjigje nga Këshilli dhe ato në proces.
3. Raporti i paraqitet Këshillit në muaji tetor të atij viti, dhe mund të propozojë afate të reja përgjigjeje për peticionet në proces.
4. Raporti i paraqitet paraprakisht Komisionit të Përhershëm për Legjislacionin dhe Zgjedhjet, komision i cili i propozon Këshillit pranimin apo ndryshimin e afatave të reja të propozuara për dhënjene përgjigjeve të peticioneve.

Neni 28

Ankesa ndaj përgjigjes së Këshillit për petiionin

1. Nëse organizatori/rëti e peticionit nuk janë të kënaqur me përgjigjen dhe veprimin e Këshillit/ Komisionit të Përherëshëm në lidhje me kërkesën e peticionit, mund t'i dërgojnë Këshillit një ankesë.
2. Ankesa duhet të paraqitet dhe do të trajtohet sipas politikës dhe procedurave të ankesave drejtuar Këshillit.

Neni 29

Administrimi i regjistrit të peticioneve

1. Sekretari ndërton indeksin dhe mirëmban regjistrin e peticioneve dërguar Këshillit dhe regjistrin e peticioneve për iniciativë qytetare që janë konsideruar të vlefshëm. Ky regjistërt publikohet në faqene interte te bashkisë.
2. Përgjigjet e Këshillit ndaj peticioneve të iniciativave qytetare publikohen në faqen e internetit të Bashkisë.

KREU III. PETICIONET PËR INICIATIVË QYTETARE

Neni 30

E drejta e iniciativës qytetare

1. Çdo grup nga komuniteti, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, kryetarit të këshillit të fshatit apo ndërlidhësit të këshillit komunitarë, apo jo më pak se një (1%) për qind e banorëve të Bashkisë me të drejtë vote, ka të drejtë të paraqesë për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak një iniciativë qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të Bashkisë.

Neni 31

Objekti i Iniciativës qytetare

1. Objekti I iniciativës është një kërkesë për t'u shqyrtuar e miratuar në Këshill një akt normativ nënligjor.

Neni 32

Nënshkruesit e peticionit për iniciativë

1. Çdo zgjedhës i regjistruar i Bashkisë mund të nënshkruajë një peticion për iniciativë.
2. Parashtruesit e peticionit janë pesë votues të regjistruar të Bashkisë, emrat e të cilëve duhet të paraqiten në peticion.

3. Nëse peticioni nuk përcakton qartë se kush është parashtruesi/t, Këshilli nuk do tashqyrtojë peticionin për iniciativë.
4. Nënshkrimi bëhet me bojë.
5. Asnjë person nuk lejohet: a) të nënshkruaj në emrin e një personi tjetër në çfarëdo rrethane, b) të nënshkruaj një peticion më shumë se një herë, c) të nënshkruaj një peticion kur nuk ka të drejtë ta nënshkruani atë.
6. Një person nuk mund të nënshkruaj njëkohësisht një peticion në letër dhe një peticion elektronik, të dy për të njëjtën çështje.
7. Këshilli ka të drejtën të verifikojë emrin dhe adresën dhe nënshkrimin e çdo personi që mbështet peticionin nëse e konsiderojmë të nevojshme.\
8. Një nënshkrues i peticionit mund të tërheqë nënshkrimin e tij / saj duke parashtruar me shkrim tek Sekretari një revokim të verifikuar të nënshkrimit nga peticioni përpara pranimit të peticionit për iniciativë.

Neni 33

Parashtruesit e Peticionit për Iniciativë

1. Parashtruesit që përfaqësojnë një organizatë duhet të marrin dhe paraqesin tek Bashkia autorizimin nga organizata për të qënëparashtruesi të peticionit.
2. Parashtruesit e peticionit nuk mund të jenë deputet ose anëtarë të Këshillit Bashkiak _____.

Neni 34

Mënyra dhe forma e paraqitjes së Iniciativës Qytetare

1. Peticionet i drejtohen Këshillit në fomë të shkruar dhe nënshkruhen në shkresë apo në formë elektronike.
2. Peticionet qëpranohen për shqyrtim me shkresë, kanë të dhënat e mëposhtme në secilën fletë të peticionit:
 - k. citimin që i drejtohet Këshilli Bashkiak _____,
 - l. emrin dhe mbiemrin, adresën e banimit/ punës/ studimit, adresën elektronike dhe numra e telefonisë fikse dhe celulare, si dhe nënshkrimin e parashtruesve
 - m. titullin e aktit që propozohet, e cila citohen në secilën faqe të nënshkruar të peticionit dhe fillon me shprehjen "Ne të nënshkruarit me këtë peticion i kërkojmë Këshillin Bashkiak _____"
 - n. arsyet e paraqitjes së peticionit
 - o. bazën ligjore të peticionit
 - p. nënshkrimet e mbështetësve të peticionit, të cilat duhe të bëhen me bojë.
 - q. Deklaratën se "Të gjitha informacionet dhe nënshkrimet e peticionet janë janë të vërteta dhe të sakta".
 - r. Numrin e faqes (p.sh. faqja 1 nga 8, faqja 2 nga 8 etj).
 - s. Çdo rrjesht me emrin, kontakte dhe nënshkrimin e nënshkruesve duhet të ketë një numër.

- t. Peticioni duhet të jetë i shkruar apo të shtypet në njëën anë të fletës A4, në letër të bardhë.

Neni 35

Dorëzimi i Peticionit për Iniciativë Qytetare dhe Pranimi

1. Parashtruesit duhet të paraqesin dhe regjistrojnë në Bashkitë gjitha seksionet e peticionit në të njëjtën kohë.
2. Parashtruesit mund të autorizojnë, me shkrim, një përfaqësues për të paraqitur peticionin në emër të tyre.

Neni 36

Verifikimi i Peticionit

1. Sekretari bën verifikimin e formës së peticionit, dhe nëse e vlereson në përputhje me kërkesat e formës, i përcakton një numër peticionit.
2. Sekretari njofton parashtruesin e peticionit për përfundimin e verifikimit të peticionit të propozuar, brenda pesë ditëve të punës nga data e regjistrimit të peticionit.
3. Nëse iniciativa e propozuar nuk është aprovuar, ajo duhet të paraqitet përsëri me ndryshimet e kërkuara për të vazhduar procesin e miratimit.
4. Nëse parashtruesit kërkojnë një ndryshim në dokumentin origjinal të paraqitur nga parashtruesi person kontakti i peticionit, ndryshimi do të konsiderohet një regjistrim i ri i peticionit.

Neni 37

Qarkullimi për Nënshkrim i Peticionit për Iniciativë Qytetare nga Mbështetësit

1. Me marrjen e njoftimit nga Sekretari se peticioni është verifikuar, parashtruesit e qarkullojnë peticionin për nënshkrime të mbështetësve.
2. Nëse parashtruesit nuk arrijnë të paraqesin një peticion për iniciativë brenda dy vitesh pasi të jetë aprovuar peticioni për qarkullim dhe nënshkrime të mbështetësve, ata duhet të ri-paraqesin peticionin për miratim nga Bashkia.

Neni 38

Konsultimi me Kryetarin e Bashkisë për Iniciativën Qytetare

Propozimet e ardhura në Këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e Bashkisë, shqyrtohen në Këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.²

²Ligji nr. 139/2015, Neni 20/2

Neni 39

Mbledhja e nënshkrimit për Peticionin për Iniciativë Qytetare

apo jo më pak se një (1%) për qind e banorëve të Bashkisë me të drejtë vote

Neni 40

Verifikimi i nënshkrimeve për Peticionin për Iniciativë Qytetare

1. Drejtoria e Juridike a Bashkisë verifikon nënshkrimet e parashtruesve dhe mbështësve dhe numrin minimal të domosdoshëm të nënshkruesve të peticionit, përpara se peticioni t'i kalojë për shqyrtim Këshillit.
2. Nëse nga verifikimi i nënshkrimeve rezulton se të gjitha nënshkrimet janë të vlefshme, dhe për këtë arsye numri i nënshkruesve është më i barabartë ose me shumë se 1% një përqind e banorëve të Bashkisë me të drejtë vote, drejtori i drejtorise juridike lëshon çertifikatën e vlefshmërisë së peticionit. Drejtori njofton me shkrim Sekretarin për çertifikimin e peticionit.
3. Nëse numri i nënshkrimeve të vlefshme është më i vogël se 1% një përqind e banorëve të Bashkisë me të drejtë vote, drejtoria juridike njofton me shkrim parashtruesin për plotësimin e numrit të nënshkrimeve, Brenda 5 diteve pune nga vleresimi. Parashtruesi i peticionit duhet të sigurojë nënshkrimet e nevojshme Brenda një periudhe jo me shumë se tre muaj.

Neni 41

Paraqitja e peticionit për shqyrtim në Mbledhjen Këshillit

1. Peticioni paraqitet për shqyrtim nënjë mbledhje të rregullt të Këshillit Bashkiak në një mbledhje të rregullt të Këshillit të mbajtur brenda 20 ditëve nga data e lëshimit të certifikates, pasi më parë është shqyrtuar nga Komisioni i Përherëshëm.
2. Parashtruesi i peticioni ftohet nga Sekretari të paraqesë kërkesën e peticionit para Këshillit. Paraqitja e përmbledhur e kërkesës së peticionit për maksimumi 15 minuta.
3. Shqyrtimi i peticionit bëhet sipas rregullave të mbledhjes së Këshillit.
4. Këshilli Bashkiak vendos për pranimin, ndryshimin apo hedhjen poshtë të kërkesës së peticionit për initiative qytetare.
5. Vendimi për pranimin apo refuzimin e iniciativës nuk merret në mbledhjen e Këshillit Bashkiak ku iniciativa prezantohet për herë të parë, përveç rastit kur me vendim të shumicës së të gjithë Këshilltarëve vlerësohet se iniciativa trajton një rast që Këshilli e vlerëson si rast emergjent.
6. Këshilli shqyrton dhe debaton iniciativës pas paraqitjes së raportit dhe propozimeve të Komisionit. Këshilli me shumicën e votave dhe brenda 90 ditëve nga depozitimi i iniciativës në Bashki, vendos pranimin e shqyrtimit të iniciativës dhe marrjen e vendimit nga Këshilli.
7. Miratimi i iniciativës qytetare bëhet me shumicën absolute të votave të të gjithë Këshilltarëve.

Neni 42

Seanca dëgjimore për Iniciativë Qytetare

1. Kryetari i Këshillit, fton një seancë dëgjimore publike me përfaqësues të autorizuar të banorëve që kanë nënshkruar iniciativën. Seanca organizohet nga Sekretari dhe në të marrin pjesë sëpaku Kryetari i Komisionit të Mandateve, Legjislacionit, Rregullores dhe Zgjedhjeve, Kryetari i Komisionit që mbulon fushën e iniciativës qytetare, kryetarët e Grupeve më të mëdha politike të Këshilltarëve dhe përfaqësues të drejtorisë që mbulon çështjet të cilën trajton iniciativa qytetare.
2. Mbas dëgjësës publike dhe shprehjes me shkrim të mendimit të Kryetari të Bashkisë, iniciativa shqyrtohet nga Komisioni për Mandatet, Rregullore, Çështjeve Juridike, Zgjedhjet dhe Peticioneve. Përfaqësuesit e autorizuar të grupit që ka paraqitur iniciativën ftohen në mbledhjen më të afërt të Komisionit. Anëtarët e Komisionit kanë të drejtën t'u paraqesin përfaqësuesve të peticionit pyetjet dhe komentet e tyre mbi çështjen që trajton iniciativa.

Neni 43

Tërheqja e Peticionit për Iniciativë Qytetare

1. Prashtruesi i peticionit mund ta tërheqë peticionin në çdo kohë përpara se Sekretari të vërtetojë se peticioni është kualifikuar për prezantim në Këshill.
2. Një nënshkrues i peticionit mund të tërheqë nënshkrimin e tij / saj duke paraqitur Sekretarit një revokim të verifikuar të nënshkrimit nga peticioni përpara pranimit të peticionit nga Sekretarit.

Neni 44

Tërheqja e Peticionit për Iniciativë Qytetare

Privacia dhe Konfidencialiteti

3. Parashtruesit e peticionit duhet të njihet me përgjegjësitë e tyre në lidhje me mbledhjen e informacionit personal (emrat, adresën dhe nënshkrimet) e mbështetësve.
4. Parashtruesit e peticionit nuk duhet të shpërndajnë informacioni tek palë të treta, përveç se tek Këshilli Bashkiak _____.

Shtojca nr. 1 Model peticion dërguar Këshillit Bashkiak

Shtojca nr. 2 Model pet...

Shtojca nr. 2

PETICION PER INICIATEN QYTETARE DREJTUAR

KESHILLIT TE BASHKISE _____

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë _____:

Adresa: Tel: Cel: Email:

1. Ne, të nënshkruarit banues të regjistruar të Bashkisë _____, të Qarkut _____, dhe banues në adresat e përcaktuara anash emrave tanë përkatës, duke qenë të barabartë me një përqind (1%)³ të numrit të përgjithshëm të banorëve të regjistruar të Bashkisë, me respekt kërkojmë që akti/vendimi i mëposhtëm të miratohet nga Këshilli i Bashkisë _____ ose, nëse nuk miratohet nga Këshilli i Bashkisë, kërkojmë t'i paraqitet për votim referendar banorëve të Bashkisë _____.

2. Baza ligjore të peticionit është neni 20/1 i Ligjitnr. 139/2015 pPër vetë qeverisje vendore,

3. Situata/Çështja që nxiti dorëzimin e këtij peticioni është:

4. Titulli i projekt aktit/vendimit që propozojmë është si më poshtë:

(Këtu vendoset titulli i projekt aktit/ vendimit të propozuar, duke siguruar që akti/ vendimi i propozuar nuk përmban më shumë se një lëndë dhe që lënda shprehet qartë në titull, dhe pastaj vendosni një nga dy fjalitë e paraqitura më poshtë. Titulli I peticionet duhte të jetë në çdo fletët të peticionit)

(Teksti i plotë i projekt aktit/vendimit është si më poshtë:)

ose (Një kopje e plotë dhe e saktë e projekt aktit/vendimit i bashkëngjitet këtij Peticioni)

5. Deklaroj se unë e kam nënshkruar personalisht këtë peticion. Unë jam një banues i regjistruar i Bashkisë _____ dhe adresa ime e vendbanimit është deklaruar e saktë.

Nr.	Emri	Mbiemri	ID	Adresa	Firma
1					
2					
20					

6. Drejtuesi i peticionit

Emri _____ Mbiemri _____, ID _____

Firma _____

Tel: Cel: Email:

7. Dokumentet shoqëruese të peticionet janë (nëse ka):

a)-

b)-

³Ligji nr. 139/2015, neni 20/1.